



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 17/1 prot.

Tiranë, më 19. 01. 2026

V E N D I M

Nr. 11, datë 19. 01. 2026

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 02 Regj., datë 05.01.2026, të shtetases E. K., kundër Drejtorisë së Spitalit Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore¹”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në ankesën dhe dokumentacionin e përcjellë pranë KMD-së nga subjekti ankues, E. K., parashtron ndër të tjera se: *“Që prej emërimit tim si psikiatre në Spitalin Psikiatrik të Elbasanit më 1 Nëntor 2024 sipas kontratës së lidhur me Ministrinë e Shëndetësisë, jam vendosur në një pozicion jo të barabartë krahasuar me kolegët e mi. Më është deleguar ekskluzivisht puna me pacientë kronikë, të cilët qëndrojnë prej vitesh në Spitalin Psikiatrik të Elbasanit dhe për të cilët nuk parashikohet trajtim i ri mjekësor. Përkujdesja ndaj tyre kufizohet kryesisht në menaxhimin e problemeve organike dhe shprehimisht më është thënë që unë jam emëruar në këtë pavion si mjeke interniste pasi kjo ishte nevoja e spitalit. Ky vendim më ka lënë jashtë përfshirjes në trajtimin e rasteve akute dhe sub-akute, siç do të duhej të ishte ndarja e drejtë e punës mes mjekeve psikiatër. Kjo ndarje e njëanshme mendoj se është bërë qëllimisht, me qëllim uljen e rolit tim profesional si mjeke psikiatre. Më është komunikuar se, pas largimit të mjekëve të njoftuar për tu larguar, do të bëhej riorganizimi i ndarjes së pacientëve dhe i punës. Megjithatë, kjo nuk ndodhi dhe unë vazhdova të trajtohesha si mjeke interniste.*

Ndërkohë që më komunikohet se pavionet e tjera nuk kishin nevojë për psikiatër, rezultoi se pavioni nr. 5 kishte vetëm një mjek. Për më tepër, menaxhimi i këtij pavioni kryhej de facto

¹ Duke referuar diskriminim në nivel profesional.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

nga Nën-drejtori Teknik, ndërkohë që në dokumente figurohej një person tjetër. Kjo ngre dyshime për një shkëlqje, mungesë transparence, keq menaxhim dhe diskriminim, pasi një Nën-drejtor Teknik merr menaxhim klinik kur një mjek psikiatër lihet të merret me problemet organike të pacientëve kronikë. Gjithashtu, ngre edhe një tjetër problem serioz, sepse pavioni kishte më pak staf mjekësor se sa kërkohet për funksionimin normal.

Largimi i mjekëve ekzistues u parashikua të zëvendësohej me mjekë të rinj nga jashtë, pa u kryer riorganizimi i shpërndarjes së punës midis pavioneve dhe mjekëve - bazuar në atë që u komunikua zyrtarisht. Menjëherë pas ardhjes së mjekes që zëvendësoi mjekun përgjegjës të pavionit nr. 2 (pavioni kronik) dhe nr. 6 (pavioni sub-akut), u lëshua një urdhër i brendshëm për ta caktuar atë në pavionin nr. 5 me pacientë akut, si dhe në pavionin nr. 4, me pacientë sub-akut. Ndërkohë, unë vijova të qëndroj e vetme në pavionin nr. 2, duke u kujdesur për rreth 60 pacientë plotësisht kronikë, në kushte që nuk përmbushin standardet e punës dhe bien ndesh me rekomandimet e OBSH-së. Pra një shembull i hapur i një sjellje tendencioze kundra meje, edhe pse mundësia për të lëvizur ishte e mundur (ndryshe nga ç'më komunikoj mua). Para ardhjes së mjekëve të rinj, kërkesa ime për t'u emëruar në pavionin nr. 5 u refuzua me pretekstin se 'nuk ka vend', gjë që tregon mungesë transparence dhe riorganizim të parregullt. Pse për mua s'paska pasur vend? Për më tepër, pavioni nr. 7 kishte tre mjekë, ndërsa pavioni nr. 5 kishte vetëm një mjek, duke krijuar një shpërndarje të pabarabartë dhe joefikase të burimeve njerëzore.

I vetmi rast kur jam informuar se mund të kem pacientë të tjerë përveç atyre të pavionit nr. 2 ka qenë gjatë një mbledhjeje rutinë të mëngjesit. Në atë mbledhje, më është komunikuar që të mbaj vetëm pacientët e mjekut të larguar në pavionin nr. 6. Megjithatë, ky komunikim ka qenë jozyrtar, pa mbështetje në një vendim të shkruar dhe pa qartësi lidhur me kohëzgjatjen e këtij angazhimi - nëse do të vazhdonte deri në ardhjen e mjekut të ri apo do të ishte i përhershëm. Pasi në atë moment ishte e paqartë dhe nëse 60 pacientët e pavionit nr. 2 do i mbaja vetëm unë apo do vinte dikush tjetër.

Pas largimit të mjekut përgjegjës të pavionit ku jam caktuar (nr. 2), edhe pse kam punuar mbi një vit në spital dhe kam njohur të gjithë pacientët e pavionit, drejtorja zgjodhi që drejtimin e pavionit t'ia besonte një mjeku të sapoemëruar, në kundërshtim me sa më ishte komunikuar më parë, duke më lënë mua në heshtje dhe pa përgjegjësi. Ndërkohë, kolegët e mi të emëruar, janë caktuar në pavione me natyrë të ndryshme rastesh psikiatrike, jo vetëm me pacientë kronikë siç më është lënë mua. Pra, përkundër përvojës sime dhe njohjes së thellë të pacientëve, nuk më është dhënë e drejta e përgjegjësisë së pavionit, një privilegj që u është dhënë menjëherë kolegëve të sapoardhur.

Sa herë kam kërkuar trajtim të barabartë, të drejta në punë, apo zgjidhje të konflikteve nga drejtorja, kam hasur në mungesë përgjigjeje, mungesë transparence dhe tendencë për të injoruar shqetësimet e mia, çështjet janë lënë në harresë, pa u marrë masa konkrete”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit të saj nga ana e Drejtorisë së Spitalit Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan, për shkak të gjendjes arsimore.

Pas regjistrimit të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me dokumentacionin provues sa i përket shkakut të pretenduar nga ana e subjektit ankues dhe provueshmërisë së tij.

Për këtë arsye, nëpërmjet e-mail-it datë 08.01.2026, nga ana e inspektorit të çështjes është proceduar me kërkesën për plotësimin e dokumentacionit e informacionit të nevojshëm sa i përket shkakut të pretenduar dhe provueshmërisë së tij për vijimin e shqyrtimit të ankesës së saj, duke i lënë dhe një afat të arsyeshëm kohor.

Nëpërmjet e-mail-it datë 11.01.2026, ankuesja në përgjigje të kërkesës për plotësimin e ankesës, ka informuar Komisionerin ndër të tjera se: *“...Nuk jam në gjendje të përcaktoj me saktësi arsyet që kanë çuar në këtë sjellje diskriminuese ndaj meje. Megjithatë, një nga arsyet e mundshme është ulja e figurës time si mjeke. Siç ju kam shpjeguar më parë (dhe siç mund të shikoni bashkëlidhur nga komunikimet me zyrën e bashkëqeverisjes), ekzistojnë fakte që vërtetojnë vendimet diskriminuese të marra ndaj meje, mungesa e vendimeve të brendshme për lëvizje të stafit mjekësor, si dhe sjellje preferenciale ndaj mjekëve të ardhur pas meje. Kërkesa ime nuk përqendrohet në zbulimin e shkaqeve që kanë sjellë këtë situatë, por në ndalimin e kësaj qasjeje ndaj meje dhe në një rishpërndarje të drejtë të punës, ku çdo mjek të ndihet i barabartë. Mbi të gjitha kam kërkuar ngritjen e një komisioni të jashtëm për të investiguar këtë sjellje. Nuk është detyra ime të bëj investigime të tilla...”*

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Në ankesën e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është pretenduar se trajtimi i padrejtë apo i pafavorshëm i ankueses nga ana e Drejtorisë së Spitalit Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan, ka ardhur për shkak të gjendjes arsimore.

Së pari, dokumentimi i shkaqeve për të cilat pretendohet diskriminimi është thelbësor në çështjen e provimit të tij, për të cilin ankuesi pretendon se ka ardhur si pasojë e posedimit të tyre.

Së dyti, pasi ankuesja të ketë provuar se mbart shkakun e pretenduar, duhet që të sjellë indicie, fakte apo prova që të dokumentojë, se pikërisht bazuar në këtë shkak (gjendja arsimore), ajo është trajtuar në mënyrë të pabarabartë e të pafavorshme nga ana e Drejtorisë së Spitalit Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim *për shkak të gjendjes arsimore*, ankuesja ka pretenduar se: “...një nga arsytet e mundshme është ulja e figurës time si mjeke. Siç ju kam shpjeguar më parë (dhe siç mund të shikoni bashkëlidhur nga komunikimet me zyrën e bashkëqeverisjes), ekzistojnë fakte që vërtetojnë vendimet diskriminuese të marra ndaj meje, mungesa e vendimeve të brendshme për lëvizje të stafit mjekësor, si dhe sjellje preferenciale ndaj mjekëve të ardhur pas meje. Kërkesa ime nuk përqendrohet në zbulimin e shkaqeve që kanë sjellë këtë situatë, por në ndalimin e kësaj qasjeje ndaj meje dhe në një rishpërndarje të drejtë të punës, ku çdo mjek të ndihet i barabartë.”.

Dokumentimi i një karakteristike individuale është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas, të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me një karakteristikë individuale.

Në rastin konkret, ankuesja ka vënë në dispozicion të Komisionerit fakte dhe prova sa i përket arsimimit të saj, por nuk ka argumentuar dhe provuar se si ka ndikuar gjendja arsimore tek situata diskriminuese e pretenduar. Nga parashtrimet e saj, ajo ka pretenduar trajtimin e pafavorshëm dhe të pabarabartë të saj, në raport me kolegët. Sakaq, pretendimet e ankueses mbeten deklarative dhe të paprovuara se si gjendja arsimore e saj, ka shërbyer në situatën diskriminuese të pretenduar.

Komisioneri vlerëson se, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese në radhë të parë duhet të provojë se, shkakun i pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit, dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe

kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak. Megjithatë, vetëm identifikimi i një ose më shumë shkaqeve, të cilat mbrohen në mënyrë të shprehur nga ligji, nuk është e mjaftueshme për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për një ose më shumë se një nga shkaqet e mbrojtura, duhet të parashtrojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun ose shkaqet e mbrojtura.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit*, *kufizimit*, *përjashtimit* ose *preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të saj që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesja nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri apo trajtim të pabarabartë, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri vlerëson, se ankuesi nuk ka dhënë informacion për të shpjeguar dhe dokumentuar, se si kanë ndikuar shkaqet e pretenduara në trajtimin e pafavorshëm të tij, në kuptim të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”³.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/b, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, i cili citon se: “*Ankesa nuk pranohet nëse: ..., b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;*”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁴.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

³ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

⁴ Për analogji citojmë vendimet: nr. 4, datë 08.01.2024, nr. 160, datë 29.05.2024 dhe nr. 177, datë 05.08.2025 të KMD-së.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 02, datë 05.01.2026, të subjektit ankues, E. K., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja arsimore)

(Fusha: Punësim)